

VENDIM
Nr.43, datë 13.1.1997

PËR PAGESËN E PUNONJËSVE TË DISA LINJAVE TEKNOLOGJIKE USHTARAKE NË KUSHTE TË VËSHTIRA PËR VAZHDIMIN E VEPRIMTARISË PRODHUESE

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e disa linjave teknologjike ushtarake, të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi janë të pazënë me punë si rrjedhim i ndërprerjes së porosive dhe që në të ardhmen parashikohen të riaktivizohen përsëri për nevojat e mbrojtjes, përfitojnë pagën mesatare mujore aktuale të ndërmarrjeve respektive, shtesën mbi këtë pagë për çdo vit vjetërsie pune, por jo më shumë se 25 për qind, si dhe kompensimin për bukë e ushqim njëjloj si punonjësit e sistemit buxhetor. Kjo pagesë jepet për një periudhë kohore deri në 2 vjet.

2. Të drejtën për t'u trajtuar sipas pikës 1 të këtij vendimi e përfitojnë punonjësit e linjave të prodhimit ushtarak të kombinatit mekanik, në Poliçan uzinës së lëndëve plasëse në Mjeks dhe uzinës mekanike Gramsh, të cilët kanë përfituar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.197, datë 4.5.1994 ose kanë qenë të punësuar në këto ndërmarrje në mënyrë të pandërprerë për një periudhë kohore jo më pak se 2 vjet, nuk zhvillojnë veprimtarinë ekonomike në formën e punësimit ose të vetëpunësimit dhe nuk ka ndryshuar vendbanimin familjar. Këto punonjës janë të detyruar që me kërkesën e drejtorive të ndërmarrjeve të marrin pjesë në ritrajnimin periodik, lëshimin e linjave teknologjike për kontroll, eksperimentime, për mirëmbajtjen e tyre, si dhe në punët e nevojshme publike në nivel lokal. Për moszbatimin e detyrimeve të mësipërme të ndërpritet pagesa e parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Punonjësit e këtyre ndërmarrjeve, që me hyrjen në fuqi të këtij vendimi mbeten në punë ose mund të merren në punë në të ardhmen, kur për shkaqe të ndryshme humbasin vendin e punës, nuk përfitojnë nga ky vendim i Këshillit të Ministrave dhe trajtohen sipas ligjit nr.7521, datë 30.10.1991.

4. Fondet financiare për kryerjen e pagesave të këtyre punonjësve të pazënë me punë të përballohen nga fondet financiare buxhetore akorduar Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale.

5. Periudha e pagesës së punonjësve sipas këtij vendimi konsiderohet vjetërsi pune në profesionin e mëparshëm për efekt pensioni dhe shënohet si e tillë në librezën e punës. Për këta punonjës të gjitha llojet e kontributeve të parashikuara në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" të përballohen nga shteti.

6. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, si dhe Ministria e Mbrojtjes të nxjerrin udhëzimet e nevojshme në zbatim të këtij vendimi, ku të jenë të përcaktuara edhe linjat teknologjike që do të ndërpresin procesin e prodhimit.

7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.197, datë 4.5.1994 "Për fillimin e procesit të rikonstruksionit të kombinatit mekanik në Poliçan", shfuqizohet.

8. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të paraqesë në Këshillin e Ministrave alternativat e mundshme të zhvillimit të këtyre ndërmarrjeve deri më 30.3.1997.

Ky vendim hyn në fuqi nga data 1 janar 1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

LISTA E REPARTEVE DHE LINJAVE TEKNOLOGJIKE, PUNONJËSIT E TË CILAVE TRAJTOHEN SIPAS KËTIJ VENDIMI.

A. Në kombinatin mekanik Poliçan (nr.punonjësve 1450)

1. Linjat e prodhimit të fishekut kallashnikov (nr.102)
2. Linjat e prodhimit të fishekut makarov (nr.509)
3. Linjat e prodhimit të kapsollave (zona "C")
4. Linjat e montimit dhe mbushjes me lëndë (zona "B")
5. Reparti i fonderisë (nr.111)

6. Reparti i përpunimit mekanik të predhave (nr.113)
7. Reparti i bojatisjes (nr.114)
8. Reparti i prodhimit të djegoreve (nr.650)
9. Reparti i kaldajave në zonën “A” dhe “D”
10. Reparti i zdrukthtarisë (nr.121)
11. Reparti instruktoral (nr.118/1 dhe nr.118/2)
12. Reparti i transportit
13. Reparti elektrik
14. Reparti komunal
15. Linja e prodhimit të fishekut mod.53, 7.62x54 mm (nr.P3)
16. Linja e prodhimit të fishekut 12.7x104 mm (nr.PI)
17. Linja e stampimit në të ftohtë (nr.112)
18. Repartet (nr.108, nr.119, nr.122)

B. Në uzinën e lëndëve plasëse Mjekës (nr. punonjësve 250)

1. Linja e prodhimit të baruzit të zi dhe fitilit
2. Linja e prodhimit të nitrocelulozës
3. Linja e prodhimit të barutit me një dhe dy bazë
4. Linja e prodhimit të eterit etilik dhe rigj. solventeve
5. Linja e prodhimit të neksogjenit dhe të neksotolit
6. Linjat e prodhimit të dy e trinitrotoluolit
7. Linja e kipit dhe elektriku (pjesa e punonjësve që ju shërben linjave të mësipërme)